

03.11.2020

STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
WELLNES PLUS SHPK

KREU I
EMERTIMI – SELIA – OBJEKTI - KOHEZGJATJA

Neni 1

Emertimi

- 1.1 Shoqeria eshte krijuar ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar. Emertimi i shoqerise eshte WELLNES PLUS Shpk. (ne vijim e quajtur "Shoqeria").
- 1.2 Shoqeria ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" te ndryshuar ("Ligji Tregtar"), legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe me kete Statut.

Neni 2

Selia

- 2.1 Lagja Kongresi i Lushnjes, Rruga Papa Ilia Zegali, pallati nr. 03, kati 2, 9001 Lushnje, Shqiperi.
- 2.2 Shoqeria mund te krijojë dege, zyra, filiale dhe te zhvillojë aktivitetet ne vende te tjera, brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

Neni 3

Objekti i Shoqerise

- 3.1 Shoqeria ka per objekt dhe qellim te aktivitetit importimin, eksportimin dhe shitjen me shumice e pakice te produkteve ushqimore, suplementeve e integrotoreve ushqimore dhe produkteve te tjera me origjine bimore dhe shtazore; si dhe konsulence profesionale, menaxheriale, agroteknike, studime fizibiliteti, studime tregu, etj. Per permbushjen e objektit, shoqeria mund te kryejë çdo veprimtari tjetër te natyres financiare e tregtare ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3.2 Me qellim realizimin e objektit te aktivitetit te saj, Shoqeria mund te kryejë operacione tregtare me pasuri te huajtshme dhe te paluajtshme, si dhe te administrojë, te blejë, te shesë, te japë me qira si dhe te kete interesa e pjesemarrje ne shoqeri, konsorciume te themeluara apo ne themelim e siper, qe kane objekt te ngjashem me objektin e aktivitetit e Shoqerise, ose qe i sherben realizimit te ketij objekti. Ne pergjithesi, Shoqeria mund te kryejë çdo veprimtari te nevojshme e te dobishme, te lejuar nga ligji per realizimin e objektit te aktivitetit te saj.

Neni 4

Kohezgjatja

- 4.1 Shoqeria do te zhvillojë aktivitetin e saj per nje kohezgjatje te pacaktuar duke filluar nga momenti i regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar te Republikes se Shqiperise.



- 4.2 Prishja dhe likuidimi i Shoqerise do te percaktohet me vendim te asamblese se ortakeve ne perputhje me dispozitat e ketij Statuti dhe legjislacionin ne fuqi.

KREU II KAPITALI

Neni 5

Kapitali

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 2 000 Euro (dy mije euro), i ndare ne 2 (dy) pjese, me vlere nominale 1 000 Euro (nje mije Euro) secila. Kapitali themeltar eshte teresisht i nenshkruar dhe shlyer nga ortaket.
- 5.2 Kapitali i Shoqerise apo çdo kontribut ne para per zmadhimin e kapitalit paguhet ne llogarine bankare te Shoqerise.
- 5.3 Ne rast zmadhimi te kapitalit, ortakeve iu rezervohet e drejta e perparësise per nenshkrimin e kuotave te reja ne raport me kuotat e zoteruara ne kapitalin e Shoqerise. Ne rast se ortaket nuk i nenshkruajne kuotat e reja ato mund te nenshkruhen nga ortaket e tjere ne raport me pjesemarrjen e tyre ne kapital.

Neni 6

Ortaket

- 6.1 Ortaket e Shoqerise jane si vijon:
- a) **Z. Albi Avdiu**, shtetas shqiptar, lindur në Fier, më 23.04.1990 mbajtës i pashportës me nr. personal J00423084R, madhor me zotesi te plote per te vepruar, zoterues i 1 (nje) kuote qe perfaqeson 50% (pesedhjete perqind) te kapitalit te Shoqerise;
 - b) **Z. Endrit Koçiaj**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 28.07.1983 mbajtes i dokumentit te identifikimit me nr. personal I30728046S, madhor me zotesi te plote per te vepruar, zoterues i 1 (nje) kuote qe perfaqeson 50% (pesedhjete perqind) te kapitalit te Shoqerise.
- 6.2 Kuotat jane te transferueshme dhe mund te transferohen ne çdo kohe ne perputhje me kushtet dhe afatet qe percaktohen ne ligjin shqiptar dhe ky Statut. Pergjegjesia e Ortakeve shtrihet deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin e Shoqerise.
- 6.3 Adresa e ortakeve per efekt te marrëdhënieve te tyre me Shoqerine, eshte ajo qe rezulton nga regjistri i ortakeve. Eshte detyrim i ortakeve te njoftojne ndryshimin e adreses se tyre. Administratori ka per detyre te mbaje dhe perditesoje kete regjister.

Neni 7

Kontributet dhe Financimet

- 7.1 Kontributi i ortakeve ne kapitalin e Shoqerise mund te jete ne para ose ne natyre, si pasuri te luajtshme, te paluajtshme apo te drejta.
- 7.2 Shoqeria, me kerkese te Administratorit dhe ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi, mund te grumbulloje financime nga ortaket, me te drejte kthimi, jo detyrimisht ne perpjestim me kuotat e pjesemarrjes te secilit ne kapitalin e shoqerise. Pervec kur parashikohet ne menyre specifike nga asambleja e pergjithshme e ortakeve, financimet e ortakeve ne favor te Shoqerise do te konsiderohen pa qellim fitimi.



Neni 8

Transferimi i Kuotave dhe e Drejta e Parablerjes

- 8.1 Dispozitat e këtij neni të Statutit kanë për qëllim mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, unitetit të ortakëve dhe ekuilibrit të marrëdhënieve midis tyre dhe për këtë arsye vendosen kufizimet e mëposhtme, në rastin e transferimit të kuotave.
- 8.2 Kuotat janë lirish të transferueshme; (i) midis ortakëve dhe bashkeshortëve apo femijëve të tyre (ii) midis ortakëve dhe shoqërive të kontrolluara nga ortakët ose shoqërive kontrolluese të ortakëve (iii) midis ortakëve.
- 8.3 Kuotat janë lirish të transferueshme me testament ose nepërmjet trashëgimisë ligjore nga ortaku tek bashkeshorti/ja apo femijet (Trashëgimtaret e Njohur). Në rast se kuotat e përfituara nepërmjet trashëgimisë, zotërohen nga më shumë se një Trashëgimtar i Njohur, të drejtat e trashëgimtareve të lidhura dhe që rrjedhin nga kjo kuota do të ushtrohen nga një përfaqësues i përbashkët i trashëgimtareve. Në rast se kuotat do të transferohen tek një trashëgimtar i ndryshëm nga Trashëgimtaret e Njohur, Shoqëria ruan të drejtën të riblejë kjo kuota nga trashëgimtaret në fjalë me një vlerë të përcaktuar nga ekspertët i caktuar për këtë qëllim. Kjo riblerje duhet të realizohet brenda një viti nga transferimi i kuotave tek ky trashëgimtar. Ky parashikim nuk do të zbatohet në rast se ortakët e Shoqërisë me vendim unanimit pranohet si ortak të Shoqërisë këtë trashëgimtar.
- 8.4 Ortaku, që ka për qëllim të shesë apo të transferojë pjesëmarrjen e tij, duhet të njoftojë me leter rekomandë Administratorin në adresën e selisë së Shoqërisë. Njoftimi duhet të përmbajë të dhënat personale të transferuesit të kuotave dhe të përfituesit të tyre, vlerën nominale të kuotës që do të transferohet, kushtet e transferimit, duke përfshirë çmimin dhe menyrat e pagesës.
- 8.5 Administratori brenda 7 (shtatë) ditësh nga marrja e njoftimit për transferimin, do të njoftojë ortakët e Shoqërisë në lidhje me transferimin në fjalë.
- 8.6 Ortakët, të cilëve iu drejtohet njoftimi si më sipër, duhet të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për mbi pjesëmarrjen se ciles i referohet njoftimi duke i dërguar ortakut ofruar dhe Administratorit me leter rekomandë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e njoftimit, deklaratën e ushtrimit të së drejtës së parablerjes.
- 8.7 Në rast se ortakët e tjerë dhe ortaku transferues nuk bien dakord me çmimin e kuotave të propozuar ky i fundit, apo me vlerën e tregut në rastin e transferimit të kuotave pa kundërshtim, ata do të caktojnë një ekspert për të përcaktuar çmimin sipas vlerës së tregut, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Pas njoftimit të çmimit të shitjes së kuotave të përcaktuar nga ekspertët, ortakët brenda 15 (pësembe dhjetë) ditësh duhet të njoftojnë me leter rekomandë Administratorin dhe ortakun transferues për interesimin e tyre të blejnë kuotat me çmimin e përcaktuar nga ekspertët.
- 8.8 Në rastin e ushtrimit të së drejtës së parablerjes nga ana e më shumë se një ortaku, pjesëmarrja e ofruar do t'i takojë ortakëve të interesuar në përpjestim pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin e Shoqërisë.
- 8.9 Nëse një ose disa nga ortakët që kanë të drejtën e parablerjes nuk dëshirojnë apo nuk mund të ushtrojnë këtë të drejtë, e drejta e tyre e parablerjes u kalon automatikisht dhe në përpjestim ortakëve të tjerë.
- 8.10 Nëse asnjë nga ortakët nuk ka për qëllim të blejë pjesëmarrjen e ofruar sipas menyrave dhe kushteve të përshkruara këtu, ortaku transferues do të jetë i lirë t'ja transferojë të gjithë pjesëmarrjen blerësit të përcaktuar në njoftimin dërguar ortakëve të tjerë. Transferimi do të



konsiderohet si i miratuar ne heshtje nese ortakut transferues nuk i paraqitet asnje njoftim per ushtrimin e te drejtes se parablerjes brenda 30 (tridhjetë) ditësh, ose kur nuk është arritur asnje marreveshje brenda gjashtedhjetë 60 (gjashtedhjetë) diteve nga data e njoftimit te transferimit ne fjale nga ortaku transferues.

- 8.11 E drejta e parablerjes duhet te ushtrohet per te gjithë pjesëmarrjen e ofruar.

KREU III ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Neni 9

Asambleja e ortakeve dhe kompetencat e saj

- 9.1 Ne baze te ligjeve dhe dispozitave te ketij Statuti, asambleja e pergjithshme e ortakeve te Shoqerise eshte organi me i larte vendimmarres i Shoqerise. Ajo perfaqeson te gjithë ortakët dhe vendimet e saj, te marra ne perputhje me ligjin dhe kete Statut, jane detyruese per te gjithë ortakët, perfshire ata qe nuk marrin pjese ne votim dhe qe votojne kunder ketyre vendimeve.
- 9.2 Vendimet per çështjet e meposhtme te Shoqerise mund te miratohen ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme te ortakeve ose nepermjet konsultimit me shkrim:
- a) percaktimi i politikave tregtare te Shoqerise;
 - b) miratimi i ndryshimeve te Statutit;
 - c) emerimi e shkarkimi i Administratorit si dhe percaktimi i kompetencave dhe shperblimit te tij;
 - d) emerimi e shkarkimi i likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar si dhe percaktimi i shperblimit te tyre;
 - e) mbikeqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga Administratori, perfshire mbikeqyrjen e pergatitjes se pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - f) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve perkates dhe brenda gjashte muajsh nga perfundimi i vitit financiar;
 - g) zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit te Shoqerise pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve perkates;
 - h) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - i) caktimin e perfaqesuesit te Shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj Administratorit;
 - j) miratimin e riorganizimit te Shoqerise, perfshire bashkimin me shoqeri te tjera, ndarjen e Shoqerise, shnderrimin e Shoqerise si dhe prishjen e Shoqerise;
 - k) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese se ortakeve;
 - l) shperndarjen e fitimit dhe mbulimin e humbjeve;
 - m) çështje te tjera te përcaktuara ne Statut ose ligj.

Neni 10

Perfaqesimi dhe Kuorumi



- 10.1 Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne asamblene e pergjithshme dhe te votoje sipas kuotave qe zoteron ne kapitalin e nenshkuar e te shlyer te Shoqerise.
- 10.2 Ortaket mund te perfaqesohen ne asamblene e pergjithshme nga nje ortak tjetër apo nje person i trete te autorizuar nepermjet prokures me shkrim.
- 10.3 Pervec se kur parashikohet ndryshe nga Statuti, ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetëm nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qel zotëroje me shumën se 30 per qind te kuotave. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose për çështje, te cilat kërkojnë shumice te kualifikuar, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetëm nese ortaket qe zotërojnë me shume se gjysmën e numrit total te votave janë te pranishëm
- 10.4 Per te vendosur zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit, asambleja e pergjithshme e ortakeve konsiderohet e mbledhur rregullisht kur jane te pranishem ose te perfaqesuar ortaket qe zoterojne me shume se gjysmën e numrit total te votave dhe vendimet duhet te merren me tri te katërtat e votave te ortakeve pjesëmarrës.
- 10.5 Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te vendose per shkak te mungeses se kuorumit te percaktuar me lart, ajo mblidhet perseri jo me vone se 30 (tridhjetë) dite, me te njejtin rend dite.

Neni 11

Thirrja e Asamblese se Pergjithshme

- 11.1 Asambleja e pergjithshme e ortakeve duhet te thirret te pakten nje here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar per miratimin e pasqyrave financiare dhe raportit te ecurise se veprimtarise te Shoqerise te hartuar nga Administratori, si dhe çdo here qe gjykohet e nevojshme nga Administratori, si dhe kur kjo kerkohet me shkrim nga nje ose disa ortake qe zoterojne te pakten 5% (pese perqind) te kapitalit te Shoqerise. Ne rastin e fundit nese Administratori nuk e thërret asamblene brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditesh nga paraqitja e kerkeses se ortakeve te siperpermendur, keta te fundit kane te drejte ta thërresin vete asamblene e pergjithshme te ortakeve, duke percaktuar rendin e dites, kohen dhe vendin e takimit ne perputhje me procedurat e percaktuara ne dispozitat ne vijim.
- 11.2 Gjithashtu asambleja e ortakeve thirret ne rastet kur:
- (a) sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 (tre) muajve ne vazhdim.
 - (b) shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjetër aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5% (pese per qind) te asetëve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
 - (c) shoqeria, brenda 2 (dy) viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5% (pese per qind) te asetëve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- 11.3 Asambleja e pergjithshme e ortakeve mblidhet ne seline ligjore apo prane nje vendi tjetër brenda ose jashte Shqiperise.
- 11.4 Mbledhja e asamblese se pergjithshme te ortakeve thirret me ane te nje njoftimi me shkrim te derguar me poste te regjistruar ose faks ose nepermjet postes elektronike qe i drejtohet secilit prej ortakeve. Njoftimi duhet te tregoje rendin e dites, vendin, daten dhe oren e mbledhjes dhe do t'i dergohet secilit ortak, jo me vone se 7 (shtate) dite perpara dates se parashikuar per

- mbledhjen e asamblese. Gjithashtu, njoftimi duhet te permbaje, edhe menyren e pjesemarrjes ne asamblese e ortakeve dhe/ose menyren e vendimmarrjes.
- 11.5 Njoftimi i mbledhjes mund te parashikojte edhe nje date te dyte per mbledhjen e asamblese ne rast se mbledhja e pare nuk zhvillohet sipas njoftimit, ne perputhje me percaktimin ne nenin 10.5 te ketij Statuti.
- 11.6 Ne rastin kur njoftimi i mbledhjes behet nepermjet postes elektronike (e-mail), njoftimi konsiderohet i marre nga ortaket ne daten/oren e shenuar ne mesazhin e marrjes/dorezimit te njoftimit te postes elektronike.
- 11.7 Ne rastin kur njoftimi i mbledhjes behet me faks, njoftimi konsiderohet i marre nga ortaket ne date/oren e shenuar ne mesazhin e marrjes/dorezimit te gjeneruar nga pajisja e faksit.
- 11.8 Mbledhjet e asamblese se pergjithshme te ortakeve dhe vendimet e saj jane te vlefshme, edhe pa thirrje formale, kur marrin pjese te gjitha ortaket qe perfaqesojne te gjitha kapitalin e Shoqerise.
- 11.9 Asambleja e pergjithshme e ortakeve kryesohet nga personi i emeruar nga shumica e ortakeve pjesemarrres (ne vijim i quajtur "Kryetari i Mbledhjes").
- 11.10 Kryetari i Mbledhjes emerohet sekretarin, i cili harton procesverbalin e mbledhjes se asamblese.
- 11.11 Ortaket mund te marrin pjese ne mbledhjen e asamblese nepermjet mjeteve elektronike si telekonferenca, video-konferenca, apo komunimit video-shkrues.
- 11.12 Perdorimi i mjeteve elektronike do te kryhet duke marre te gjitha masat teknike te nevojshme per garantimin e identifikimit te ortakeve, si edhe sigurine e ketyre mjeteve elektronike. Ne vecanti eshte e nevojshme qe:
- (i) Kryetari i Mbledhjes te kete mundesine te verifikojte dhe te identifikojte ortaket te cilet jane te pranishem, te kontrolloje mbarevajtjen e mbledhjes, te numeroje dhe te shpalle rezultatin e votimit;
 - (ii) Sekretari dhe/ose mbajtesi i procesverbalit te kete mundesine per t'u njohur me faktet dhe ngjarjet e ndodhura ne mbledhjen, objekt te procesverbalit;
 - (iii) Te mundesohet pjesemarrja e te gjitha te pranishmeve per te diskutuar mbi rendin e dites, ne sqartimin, marrjen dhe shperndarjen e te gjitha dokumentave te perdorura gjate mbledhjes si dhe ne procesin e votimit mbi rendin e dites.
- 11.13 Mbledhja e asamblese ne kushtet e permendura ne nenin 11.11 dhe vijues te ketij Statuti, konsiderohet rregullisht e mbajtur ne vendin ku eshte i pranishem Kryetari i Mbledhjes, Sekretari ose mbajtesi i procesverbalit, i cili ben te mundur pergatitjen dhe mbajtjen e procesverbalit te mbledhjes.
- 11.14 Kryetari i Mbledhjes do te verifikojte identitetin e çdo ortaku pjesemarrres ose perfaqesuesve te tyre.
- 11.15 Ne rast se ortaket jane te ftuar te marrin vendime nepermjet konsultimit me shkrim, kuorumi do te quhet si i formuar bazuar ne numrin e ortakeve qe do te dergojne votimin dhe vendimet e tyre me shkrim. Administratori ose ortaket e qe kerkojne vendimarrjen duhet t'i dergojne çdo ortaku njoftimin per konsultimin me shkrim, i cili do te permbaje gjitha informacionet qe perfshihen ne letren e njoftimit/thirrjes te percaktuar ne nenin 11.4 te ketij Statuti. Procedura e konsultimit me shkrim duhet te kryhet ne perputhje me permbytjen e ketij neni, ne rastet kur zbatohet. Çdo ortak duhet te shprehet me shkrim ne lidhje me projekt-vendimet duke votuar mbi dokumentin e projekt vendimeve ne formen e derguar nga Administratori, nepermjet shenimit "pro" ose "kunder" ose duke u shprehur komentet e tyre ne nje dokument tjetër. Ne rast se ortaket kane komente, duhet t'u bejne reference te qarte projekt-vendimeve. Secili ortak duhet t'i dergoje Administratorit ose ortakeve qe kane kerkuar marrjen e vendimit nepermjet keshillimit me



shkrim, voten e tij/vendimet me shkrim brenda dates se percaktuar ne njoftimin e derguar per marrjen e vendimit nepermjet konsultimit me shkrim.

- 11.16 Vendimet e ortakeve te marra si dhe diskutimet dhe komentet e ortakeve duhet te pasqyrohen ne procesverbalin e mbledhjes te hartuar nga Sekretari i mbledhjes. Gjithashtu ky procesverbal duhet te pasqyroje menyren e organizmit te mbledhjes se asamblese apo te konsultimit me shkrim nese eshte kryer ne perputhje me ligjin dhe dipozitat e Statutit, te identifikojte ortaket e pranishem dhe te perfaqesuar ose ortaket qe kane votuar me shkrim, nese kuorumi i ortakeve qe kane votuar me shkrim eshte respektuar sipas Statutit dhe Ligjit Tregtar, si dhe nese vendimet konsiderohet te miratuara sipas votave te marra. Procesverbali do te nenshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes. Procesverbali i bashkengjitet gjithashtu lista e ortakeve qe kane votuar (pervec rastit kur procesverbali eshte nenshkruar nga gjithe ortaket) si dhe njoftimi i thirrjes se asamblese te cilat mbahen ne seline e Shoqerise. Nese vendimet e marra nga ortaket duhet te depozitohen prane Regjistrit Tregtar, procesverbali i mbledhjes dhe votat e dhena (nepermjet konsultimit me shkrim nga ortaket) do te sherbejne si dokumentet qe provojne te dhenat qe do te depozitohen ne kete regjister.
- 11.17 Ne rast se asambleja e pergjithshme e ortakeve nuk mund te shqyrtoje ne te njejten dite te gjitha ceshtjet qe duhen diskutuar, vazhdimi i mbledhjes do te behet te neserme pa pasur nevoje per njoftim te metejshem.

KREU IV ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 12

Administrimi i Shoqerise

- 12.1 Administrimi i Shoqerise do te kryhet nga Administratori i vetem.
- 12.2 Administratori i pare i Shoqerise do te jete **Z. Albi Avdiu**, shtetas shqiptar, lindur ne Fier, me 23.04.1990 mbajtës i pashaportës me nr. personal J00423084R.
- 12.3 Administratori do te emerohet nga asambleja e ortakeve dhe mund te shkarkohet ne cdo kohe me vendim te asamblese se ortakeve.
- 12.4 Administratori do te jete person fizik pa asnje kufizim per sa i perket kombesise se tij. Afati i emerimit i te Administratorit do te caktohet ne momentin e emerimit te tyre por ky afat nuk mund te jete me i gjate se 5 (pese) vjet. Pa cenuar kete kufizim afati i emerimit te tyre mund te riparterihet me vendim te asamblese se ortakeve.
- 12.5 Administratori do te rimbursohet per shpenzimet e kryera gjate ushtrimit te detyrave te tij. Asambleja e ortakeve mund te vendose te jape edhe shperblime vjetore.
- 12.6 Ne rast doreheqje Administratori do te njoftoje me shkrim asamblene e ortakeve.

Neni 13

Kompetencat e Administratorit



- 13.1 Administratori do të jetë përgjegjës për administrimin e Shoqërisë dhe do të përfaqësojë Shoqërinë kundrejt paleve të treta në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe/ose të ligjit të zbatueshëm. Administratori ka kompetencë të plotë për të marrë vendime të zakonshme dhe të jashtëzakonshme për administrimin e Shoqërisë, përveç kompetencave që do të ushtrohen nga organe të tjera të Shoqërisë sipas këtij Statuti ose ligjit të zbatueshëm.
- 13.2 Administratori do të ketë këtë kompetencë dhe detyrë që lidhen me administrimin dhe mbikeqyrjen e veprimtarisë së Shoqërisë si më poshtë:
- (a) të mbikeqyrë dhe të zbatojë politikën tregtare të Shoqërisë dhe vendimet e asamblese së përgjithshme të ortakëve;
 - (b) të sigurojë që Shoqëria respekton ligjin(et) e zbatueshëm dhe standardet kontabel;
 - (c) të kryejë të gjitha veprimet në lidhje me administrimin e veprimtarisë tregtare të Shoqërisë;
 - (d) të përfaqësojë Shoqërinë kundrejt paleve të treta;
 - (e) të sigurojë që dokumentet dhe librat kontabel të Shoqërisë të mbahen rregullisht;
 - (f) të therrase mbledhjet e asamblese së përgjithshme të ortakëve, nëse e vlerëson të nevojshme për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë;
 - (g) të përgatitë dhe nënshkruajë pasqyrat financiare vjetore të Shoqërisë, dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë të cilat bashkë me propozimin për shpërndarjen e fitimit i paraqiten për miratim asamblese së përgjithshme të ortakëve.
 - (h) të kryejë të gjitha regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme në lidhje me Shoqërinë sipas parashikimeve të ligjit të zbatueshëm;
 - (i) t'i raportojë asamblese së përgjithshme të ortakëve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe kryerjen e veprimtarive tregtare që mund të konsiderohen me rëndësi të veçantë për Shoqërinë;
 - (j) të punësojë ose të ndërprejë marrëdhëniet e punës me punonjësit sipas politikave të Shoqërisë.
 - (k) të kryejë detyrë të tjera të përcaktuara në ligj dhe në Statut.
- 13.3 Administratori mund të ushtrojë të gjitha kompetencat si dhe të kryejë të gjitha veprimet të cilat me ligj ose nga ky Statut tjetër nuk i rezervohen kompetencave të asamblese së ortakëve ose nuk kufizohen nga ky Statut apo nga ligji i zbatueshëm.
- 13.4 Administratori mund të delegojë një pjesërisht ose tërësisht kompetencat e tij tek persona të tjerë të zgjedhur sipas gjykimit të tij.

Neni 14

Përgjegjësitë e Administratorit

- 14.1 Administratori për një veprim të caktuar në të cilin përfshihen interesat e tij ose të paleve të treta të lidhura me të, të cilat i kundërvihen interesave të Shoqërisë duhet të njoftojë asambletë e ortakëve si dhe mund të mos marrë pjesë në vendimet që lidhen me këto veprime.
- 14.2 Administratori, kur personalisht apo përmes paleve të lidhura me të ashtu siç përcaktohen në nenin 13 të ligjit 9901 me datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", kanë interesat në marrëveshje të cilat do të lidhen nga Shoqëria duhet të njoftojë asambletë e ortakëve. Përfundimi i një marrëveshjeje të tillë duhet të miratohet nga asambleja e ortakëve.
- 14.3 Administratori duhet të ushtrojë detyrat e tij në mënyrë të kujdesshme në përputhje me këtë Statut, ligjin e aplikueshëm në fuqi dhe vendimet e asamblese së ortakëve.



KREU V
VITI USHTRIMOR-KONTROLLI KONTABEL-PRISHJA DHE LIKUJDIMI

Neni 15

Viti ushtrimor dhe pasqyrat financiare

- 15.1 Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 janar dhe mbyllet me 31 Dhjetor te çdo viti.
- 15.2 Ne perfundim te çdo viti financiar, Administratori harton pasqyrat financiare ne perputhje me ligjin.

Neni 16

Fitimi dhe Dividentet

Fitimet qe rezultojne nga pasqyrat financiare te miratuara rregullisht, do te shperndahen midis ortakeve ne perputhje me kuotat e zoteruara, pervec rasteve kur eshte vendosur ndryshe nga ortaket ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme ose nepermjet konsultimit me shkrim, ose do te perdoret per qellime te tjera sipas vendimit te asamblese se pergjithshme te ortakeve. Fitimi qe mund te shperndahet tek ortaket konsiston ne fitimin e vitit aktual, fitimin e realizuar ne vitet e kaluara dhe te mbartur, fitimi i realizuar ne vitet e kaluara i cili ishte destinuar per rezerven ligjore, kur qellimi i krijimit te rezerves eshte permbushur dhe ortaket vendosin te shfuqizojme rezerven ne fjale.

KREU VI
KONTROLLI KONTABEL

Neni 17

Kontrolli

Nese kerkohet nga ligji, eksperti dhe/ose ekspertet emerohen nga asambleja. Asambleja e ortakeve mund te riemeroje te njejtin/et ekspert/e. Eksperti/et shkarkohet/n nga detyra me vendim te asamblese se ortakeve ne rast mosrespektimi te detyres se tij, ne rast gabimi dhe ne rast mungese profesionalizmi ne sjellje.

KREU VII
PRISHJA DHE LIKUJDIMI

Neni 18

Prishja dhe Likuidimi

- 18.1 Asambleja e ortakeve mund te vendose per prishjen e Shoqerise. Prishja e Shoqerise do te shoqerohet me likuidimin e saj.
- 18.2.1 Shoqeria vazhdon te ekzistojte si person juridik vetem per nevoja te likuidimit deri ne perfundim te ketij procesi dhe gjate likuidimit togefjaleshi "ne likuidim e siper" duhet te vihet pas emrit te Shoqerise.
- 18.2.2 Likuiduesi/t do te emerohet me vendim te Asamblese se ortakeve. Emerimi i likuiduesit/eve dhe procesi i likuidimit do te kryhen ne perputhje me dispozitat e ligjit shqiptar.

Neni 19



Ligji i Zbatueshem dhe Juridiksioni

- 19.1 Per çeshtjet e parregulluara ne kete Statut do te zbatohet Ligji nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtarët dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar.
- 19.2 Çdo konflikt, divergjence, mosmarreveshje apo pretendim i çfaredolloji, sidoqe te kete lindur nga apo ne lidhje me kete Statut, do t'i drejtohet dhe zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

ORTAKET

Z. Albi Avdiu

Albi Avdiu



03.11.2020

Z. Endrit Koçiaj

ENDRIT KOÇIAJ

